REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni të paanshëm për rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës shtetërore, në nivel qendror e vendor, sistemit gjyqësor dhe prokurorisë, nëpërmjet rekomandimeve të dhëna dhe masave të propozuara;

Duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e këtij institucioni në mbrojtjen, krijimin, promovimin e standardeve në fushën e të drejtave themelore të njeriut dhe kontributit të dhënë për përmirësimin e legjislacionit vendas, sipas standardeve ndërkombëtare;

Konstaton se për vitin 2011:

- Avokati i Popullit, në zbatim të rezolutës së Kuvendit të vitit 2011, ka realizuar analiza lidhur me të drejtat e njeriut në vend, duke i prezantuar me të dhëna statistikore për çdo të drejtë.
- Është rritur ndjeshëm numri i çështjeve të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit.
- Në zbatim të rezolutës së Kuvendit të vitit 2011 për vlerësimin e punës së Avokati të Popullit, është bërë një prezantim më i detajuar, duke analizuar veprime të caktuara të administratave vendore, të kryera në kundërshtim me përcaktimet përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të ligjit nr. 8652, 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar.
- Numri i rekomandimeve drejtuar administratës publike është më i lartë se vitet e tjera dhe ka një statistikë pozitive lidhur me pranimin e tyre nga organet, të cilave Avokati i Popullit u është drejtuar.
- Problem vazhdon të mbetet numri i çështjeve jashtë juridiksionit që, me gjithë përpjekjet e bëra për të ulur numrin e tyre, përsëri shifra konsiderohet e lartë.
- Rezulton që gjatë vitit 2011, Avokati i Popullit ka zhvilluar një aktivitet më të gjerë krahasuar me vitet e mëparshme, lidhur me prezencën e tij në median vendore, duke u përpjekur që të sensibilizojë më shumë komunitetin për rolin dhe kompetencat e tij.
- Ka pasur një bashkëpunim formal me Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për referim masash administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë, lidhur me shkeljet e prezumuara ndaj këtyre funksionarëve.
- Ka pasur një rënie të numrit të ankesave në krahasim me vitet e kaluara.

Kërkon nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2012:

- Bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, duke e informuar më mirë për situatën e të drejtave të njeriut, dhe shkeljet e administratës publike, si dhe konsolidimin e bashkëpunimit me Shërbimin e Monitorimit të Kuvendit, si strukturë administrative, e cila ka si qëllim informimin e Kuvendit.
- Forcimin e paanësisë së institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet përdorimit sa më të efektshëm të mjeteve ligjore, në përmbushje të objektivave për vitin 2012.
- Konsolidimin e bashkëpunimit me Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, për referim masash administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë, kur konstatohen shkelje.
- Monitorimin e rekomandimeve të bëra për masat e propozuara nga Avokati i Popullit ndaj nëpunësve të administratës publike dhe institucioneve të tjera shtetërore, si dhe perfeksionimin e metodologjisë për këtë qëllim.
- Uljen e ankesave jashtë juridiksionit dhe rritjen e numrit të ankesave brenda juridiksionit, nëpërmjet vazhdimit të sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me juridiksionin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit.
- Në kuadër të funksionit si mekanizëm parandalues, Avokati i Popullit, për vitin 2012, duhet të thellojë hetimet, mbi të cilat mbështet rekomandimet e tij, nisur nga numri i inspektimeve të kryera në funksion të mekanizmit për parandalimin e torturës dhe nga rekomandimet që Avokati i Popullit ka

hartuar për këtë qëllim.

14 qershor 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)